

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-149/2014**

**Prishtinë, 9 Mars 2016**

Në çështjen juridike të:

B. D.

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, si kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami si anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/225/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA24066), i datës 27 nëntor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 9 Mars 2016, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga B. Dj. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/225/2013 të datës 27 nëntor 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në APK me numrin KPA24066, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/225/2013 i datës 27 nëntor 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA24066, vërtetohet.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 5 shkurt 2007, B. Dj. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP-së) me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e garazhit të ndërtuar më 1998 në sipërfaqe prej 18m<sup>2</sup>, në rrugën “Vojvode Putnika” nr. 2, në Prizren (tani e tutje: prona e kërkuar), si dhe kompensimin për shfrytëzimin e saj pa pëlqimin e pronarit. Pala ankuese pretendon se pronën e kërkuar e kishte humbur më 16 qershor 1999 dhe se humbja e saj kishte ndodhur si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë.
2. Pala ankuese pohon se bashkëshortja e tij ka qenë pronare e pronës së kërkuar. Ai ka treguar se garazhi ishte shfrytëzuar nga familja S.
3. Për ta mbështetur pretendimin e tij, pala ankuese i ka siguruar AKP-së dokumentet në vijim:
  - Kopjen e certifikatës së martesës nr. 61 të vitit 1971, të lëshuar nga Komuna në Kragujevc;
  - Kopjet e faturave të pagesës së taksave dhe kontributeve të bëra në vitin 1997. Në disa prej faturave shënonte se pagesa bëhej në emër të “shfrytëzimit të tokës, për ndërtesë banimi”.
4. Më 21 qershor 2007, AKP-ja ka lokalizuar pronën: garazhi nuk ekziston më, pasi që është larguar nga komuna. Në të njëjtën ditë, AKP-ja ka vendosur njoftimin në

- pronën e kërkuar. Është gjetur e lirë. Asnjë palë tjetër nuk i është bashkuar procedurës pranë AKP-së.
5. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së të datës 21 maj 2007, fletë-dërgesat janë verifikuar pozitivisht.
  6. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) përmes vendimit të tij KPCC/D/C/225/2013 të datës 27 nëntor 2013, ka refuzuar kërkesën në bazë të faktit se paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesën.
  7. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 7 mars 2014. Ai ka paraqitur ankesë më 4 prill 2014.

**Pretendimet e palës ankuese:**

8. Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta ndryshojë vendimin e KKPK-së dhe ta pranojë ankesën e tij. Në ankesë, ai pohon se vendimi i KKPK-së është bazuar në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve, si dhe përmban gabime në zbatimin e ligjit material. Sipas mendimit të palës ankuese, autoriteti pranë të cilit do të mund të bëhej vërtetimi i fakteve akoma ekziston dhe se AKP-ja do të duhej ta bënte këtë. Ai ka sqaruar se e kishte ndërtuar garazhin në parcelën e cila ishte pronë shoqërore dhe se e kishte fituar të drejtën e shfrytëzimit të parcelës. Ai ka kërkuar që të dëgjohen dëshmitarët për t'i vërtetuar pretendimet e tij, si dhe ka kërkuar që të dëgjohet edhe ai vetë në mënyrë që t'i jap të gjitha të dhënat e nevojshme.

**Arsyetimi ligjor:**

9. Në bazë të nenit 3.1 të Ligjit 03 / L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga KKPK-së për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai ose ajo nuk është në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tilla pronësore për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me, ose si rezultat i konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

10. Pyetja që duhet përgjigjur në rastin konkret është nëse pala ankuese ka qenë gjatë konfliktit dhe deri më tani pronar i pronës së kërkuar. Pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë që do të vërtetonte pretendimet e tij për të drejtën e pronësisë mbi garazhin dhe për ndërtimin e saj në bazë të lejes së lëshuar nga autoritetet kompetente. E vetmja provë dokumentuese e paraqitur nga pala ankuese ishin faturat për pagesën e tatimit, por ato nuk mund të konsiderohen si prova për rrethanat e ndërtimit të garazhit pas lejes për shfrytëzimin e tokës në pronësi shoqërore. Sipas nenit 319.1 dhe 2 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të vërtetojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta dhe të gjitha faktet relevante të nevojshme për gjykatën që të marrë një vendim. Ka qenë detyrë e palës ankuese - dhe jo e AKP-së apo e Gjykatës Supreme – që të paraqesë provat që vërtetojnë rrethanat që ai pretendon se ishin të nevojshme për të vendosur në bazë të kërkesës së tij. Dështimi për ta bërë këtë ka rezultuar në refuzimin e kërkesës, ashtu siç ka vepruar edhe KKPK-ja.
11. Kjo e shpie Gjykatën Supreme në konstatimin se KKPK-ja ka marrë një vendim korrekt për arsye të drejta kur ka refuzuar kërkesën e palës ankuese. Rrjedhimisht, ankesa e palës ankuese është refuzuar si e pabazuar dhe vendimi i Komisionit është vërtetuar si korrekt dhe i bazuar në ligj i cili është zbatuar në mënyrë të drejtë në pajtim me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
12. Këtu është e rëndësishme të theksohet se sipas nenit. 12.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Pala ankuese në ka kërkuar në ankesë që të dëgjohen dëshmitarët si dhe vetë ai. Gjykata Supreme e konsideron kërkesën si të paafatshme, duke marrë parasysh çfarë është përmendur me sipër.

13. Gjykata Supreme konstaton se pala ankuese nuk i ka përmbushur kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 3.1 të ligjit 03/L-079, sepse ai nuk a e ka vërtetuar pronësinë e tij mbi pronën e kërkuar.
14. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1(d) të LPK-së , ankesa refuzohet si në dispozitiv.

**Këshillë juridike:**

Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it**